

FJALA E DEPUTETES ERISA XHIXHO

E ENJTE DATA 2 MARS 2023

Të nderuar kolegë,

E nderuar drejtuese e seancës,

Dje ka ndodhur një ngjarje shumë e rëndë, tragjike, që duhej të kishte tronditur një shtet të tërë për situatën e pasigurisë ku jetojmë ne, sidomos për fëmijët, gratë dhe vajzat e vendit tonë. Në fakt, ajo ishte një ngjarje e paralajmëruar, prandaj nuk mund të hesht në këtë seancë dhe nuk mund të rri pa folur, pasi dje u vranë tri gra nga e njëjta dorë që plagosi edhe tri të tjera. Monstra është një vrasës dhe dhunues sistematik grash që, siç ndodh shpesh, ia ka hedhur drejtësisë. Kjo drejtësi duhet t'i bëjë shembull raste të tilla, sepse autorë të tillë arrijnë t'ia hedhin drejtësisë, e cila duhej të jepte dënim maksimal për këtë individ përsëritës. I dënuar fillimisht për përdhunim, më pas edhe për vrasje, ai është rikthyer në liri shumë më shpejt se ç'duhej. Pyetja që shtroj sot nga kjo sallë është: pse ishte i lirë, kur duhej të ishte në burg ai monstrë?! Mosveprimi i shtetit është inkurajim për vrasësit dhe po aq vrashtar sa veprimi i kriminelëve. Pandëshkueshmëria vazhdon të vrasë dhe ne jemi përgjegjës, sepse e fshehim dhunën në jetën tonë, veçanërisht dhunën ndaj grave, me statistika apo fotografite e grave në Kuvend apo në qeveri. Ne gratë e Kuvendit dhe gratë e qeverisë sot duhet të ndihemi të turpëruara, sepse nuk ia dolëm dot të mbronim: Mevlude Hysën, 30 vjeç; Hasime Dafkun, 30 vjeç; Etleva Kurtin, 31 vjeç nga vrasësi që shteti e la të lirë. Shteti e la të lirë për të vranë dhe vrasësi vrau. Sot të gjitha organet ligjzbatuese, policia, policimi në komunitet, që është një dështim, të cilat kishin për detyrë ta mbikëqyrnin në vazhdimësi, duhet të mbajnë përgjegjësi. Keni krijuar një Shqipëri të pasigurt dhe armiqësore për gratë dhe vajzat, për fëmijët dhe qytetarët, sepse ju nuk njihni as llogaridhënien dhe as dëgjoni të vërtetat ulëritëse të këtij realiteti, me të cilin përballemi dhe që është përballë jush çdo ditë.

Ndërkohë jemi këtu sot në këtë seancë mocioni me debat, pas gati dy muajsh këmbënguljeje për të sjellë Kryeministrin para nesh dhe para shqiptarëve për një skandal të përmasave ndërkombëtare. Pasi u shmang për javë të tëra, duke e deleguar detyrimin me të cilin e ngarkon Kushtetuta, Kryeministri erdhi sot për të dhënë shoun e radhës. Zgjodhi strategjinë që zgjedh gjithmonë: të recitojë hartimin e radhës, të ironizojë opozitën dhe të bëjë batuta. U përpoq ta relativizojë një çështje madhore, të parën e kësaj natyre në historinë e kryeministrave shqiptarë. Kryeministri pak më parë në foltore i ra shkurt duke mos na dhënë asnjë përgjigje. U përpoq t'u hedhë hi syve shqiptarëve për takimet e tij me ish-zyrtarin e FBI-së, duke ua shituar ato si miqësore dhe përtej çdo interesi, por që, në fakt, nuk është aspak kështu! Të gjitha takimet, për të cilat ai përmendet në aktakuzë, kanë një emërues të përbashkët: përpjekjen për të goditur opozitën shqiptare. Dëgjuam pak më parë barsolet me byrektore, kur të gjithë e dimë se jemi sot këtu pikërisht për brumin që vetë Kryeministri e gatoi e që fatmirësisht nuk ka dalë ende nga furra. Them fatmirësisht, sepse çështja shqyrtohet nga një tjetër drejtësi kësaj radhe, një drejtësi, të cilën Kryeministri nuk mundet as ta ndikojë dhe as ta intimidojë. Zoti Rama u ndal sot në të gjitha takimet e përmendura në aktakuzë, duke na thënë se kanë ndodhur, por duke mos na shpjeguar në asnjë moment se çfarë është diskutuar në to, kush i ka iniciuar dhe cila ka qenë arsyeja, kush ka qenë tjetër i pranishëm në këto takime dhe a ka të tjera që nuk kanë dalë

ende në dritë. Gjithashtu, Kryeministri u mjaftua me një përshkrim tangjent e të nxituar. Nuk na u tha asgjë për çështjen e dhënies së licencave të fushave të shfrytëzimit të naftës në Shqipëri.

Zoti Rama na përsëriti edhe një herë sot se nuk ka pasur informacion për lobimin rus dhe, nëse do ta kishte, nuk do të kursehej ta vinte në dispozicion. Megjithatë, njëri prej personave që përmendet në aktakuzë, ku emri i tij figuron 14 herë, rezultoi se e kishte këtë informacion dhe ia ka kaluar zyrtarit të FBI-së më 4 janar. Kryeministri nuk ishte aspak i sinqertë këtu para nesh sot. Ky informacion doli patjetër nga zyra e tij. Kryeministri nuk na dha përgjigje për 225 mijë dollarët që i janë paguar agjentit të FBI-së menjëherë pas takimeve me të. Cila është origjina e këtyre parave dhe në këmbim të cilit shërbim u paguan? Një ish-agjent i agjencisë më të madhe të inteligjencës amerikane është nën hetim për korrupsion dhe në hetim del emri i Kryeministrit shqiptar dhe i një oligarku rus. Vetëm kaq do të mjaftonte për të dhënë dorëheqjen në mënyrë të menjëhershme. Kryeministri e ka njollosur zyrën e Kryeministrit shqiptar dhe kjo njollë, kësaj here, i vjen nga përtej oqeanit. Të nderuar kolegë, Kryeministri foli këtu plot 40 minuta për të mos thënë asgjë. Na lexoi pasazhe të aktakuzës në shqip e anglisht, por nuk qartësoi asgjë për shqiptarët. Prej javësh ju jeni përpjekur ta bëni një çështje të dorës së fundit, duke u thënë shqiptarëve se çështja "McGonigal" është çështje qesharake në Amerikë. Në fakt, bëhet fjalë për sigurinë kombëtare të SHBA-ve. Përdorimi i zyrtarit të FBI-së në mënyrë të paligjshme dhe korruptive nga Kryeministri i Shqipërisë kundër opozitës dhe kundërshtarëve të tij politikë është shumë flagrant.

Ndaj sot në Shqipëri është i domosdoshëm hetimi i veprimeve antikushtetuese, të paligjshme nga Kryeministri shqiptar, që është e qartë se ka korruptuar zyrtarë të lartë të huaj për të porositur investime ndaj kundërshtarëve politikë, me qëllim shkatërrimin e pluralizmit politik dhe mbajtjen me çdo kusht të pushtetit të tij të pamërituar. Kryeministri shqiptar ka shkelur rëndë Kushtetutën e vendit duke shfrytëzuar detyrën dhe këtë e ka bërë për të minuar demokracinë dhe pluralizmin politik në vend. Ndërkohë bllokimi i komisionit hetimor parlamentar është shkelje flagrante e Kushtetutës, një përpjekje për të shmangur llogaridhënien, të cilën e ka detyrim kushtetues. Kryeministri nuk del dot i larë nga kjo histori as duke bllokuar komisionin hetimor dhe as duke ua hequr fjalën deputetëve të opozitës. Kryeministri, edhe pse e ka shumë problem llogaridhënien dhe transparencën, duhet të kuptojë se koha e llogaridhënies ka ardhur dhe askush nuk mund ta ndalojë. Faleminderit!